

Libri përmbillet me studimin: Humlumtimet mbi rëndësinë shoqërore të miteve, simboleve dhe ritualeve.

Çështjet e shtruara në këtë libër, nuk bëjnë fjalë drejtpërdrejt për besimet. Ky libër nuk është as pasqyrë oficijele e doktrinave religjioze e as e atyre liturgjike; por në të bëhet fjalë për simbolikën, ceremonitë dhe zakonet religjioze të religjioneve dhe të popujve të ndryshëm të botës.

Zakonet religjioze dhe ceremonitë, për të cilat bëhet fjalë këtu, janë shprehje e religjionit popullor, i cili mund të haset në të gjitha religjionet e mëdha, më së shpeshti i maskuar me forma të ndryshme të kultit oficijel, thotë Juzef Keleri. Ceremonitë dhe zakonet që i ushtron populli, shpeshherë nuk janë në pajtim me rregullat e religjionit oficijel, brenda së cilës aplikohen, sikundër që nuk janë të njëjta ndryshimet në mes të kultit popullor dhe oficijel. Kështu, bie fjala, ngjet me religjionet e Lindjes së largët, të cilat janë tolerante ndaj besimeve të tjera dhe lejojnë

që i njëjti njeri të rrëfëhet njëkohësisht në disa religjione.

Gjersa në religjionet „dogmatike”, siç është judaizmi, krishterimi dhe islamizmi, shmangiet nga principet oficijele trajtohen si shmangie nga feja si përçarje.

Shkurt, ky libër, dëshmon për faktin se religjioni nuk është vetëm aq sa kuptohet në qarqet e teologëve. Dëshmon për faktin se religjionet janë terren ku krijohen paragjykime nga më të ndryshmet, johumane, veprime të ashpra, të cilat shpeshherë konsiderohen si obligime religjioze.

Sidoqoftë, rëndësia e këtij libri, në fushën e etnologjisë, përkatësisht mitologjisë, është e madhe. Aq më parë, nga se trajtimi i problematikës zakonore, ceremoniale dhe simbolike kap një areal të gjerë të shtrirjes në disa kontinente, popuj, konfesionet fetare e religjioze. Prej këtu, pra, ofrohet mundësia për një studim komparativ.

UKE XHEMAJ

Anton Çetta, KËRKIME FOLKLORIKE, botoi Rilindja, Prishtinë, 1981.

Libri *Kërkime folklorike*, bashkë me parathënie ka nëntëmbëdhjetë punime dhe është i ndarë në dy kapituj kryesorë: *Nga proza popullore* dhe *Nga poezia popullore*.

Në punim *Për një ndarje më të plotë të prozës popullore dhe emërtimit e ca llojeve të saj* A. Çetta, autor me formimin filologjik, që në krye të librit *Kërkime folklorike*, shqyrton problemin e klasifikimit të letërsisë gojore në përgjithësi, nga mund të mësohet për orientimin teorik të autorit dhe ku tregohet prija për trajtime analitike bashkëkohore, pa lënë as mënyrën tradicionale të qasjes se problemeve të letërsisë gojore.

Në këtë trajtesë autori shtron edhe çështjen e periodizimit, respektivisht domosdonë e thellimit dhe të plotësisht me emërtime të reja të disa llojeve të prozës. Në fillim autori thekson nevojën e ngutshme të klasifikimit të letërsisë gojore, duke marrë parasysh faktin se letërsia „artistike” (e shkruar) përcaktohet dhe kushtëzohet nga letërsia gojore dhe se stu-

dimi i së parës ndihmon studimin më sistematik të së dytës. Problemet e njërës janë të lidhura ngushtë me ato të të dytës dhe autori është i bindur për vlerat e mëdha kulturore të materialeve folklorike kur ato futen në procesin e arsimit të të rinjve. Prandaj, shqyrtimi i çështjes së periodizimit dhe i emërtimit më të plotë simbas llojeve dhe nënllojeve është i rëndësishëm për shumë arsye. Mbi të gjitha del i nevojshëm saktësimi dhe rishqyrtimi i termave.

Duke nisur nga këto këndshikime teorike, A. Çetta bëri mbledhjen e folklorit ndër vise të ndryshme të Kosovës dhe hodhi hullinë e parë dhe të thellë të shpjegimit dhe interpretimit të letërsisë gojore, që padyshim shërben si inicim për studime të specializuara të krijimeve të gjithfarshme gojore. Ndihmesa e A. Çettës është e madhe sidomos në saktësimin terminologjik sikundër është e tillë edhe në trajtimin e secilës çështje, me të cilën merret ky autor.

Këto punime të A. Çettës për çështje të caktuara, as tash nuk kanë

humbur nga aktualiteti. Ato shërbyen, ndonjëherë si parathënie të botimeve të veçanta nga po ky autor (Shih: *Përralla I*, Prishtinë, 1979, parathënie, *Balada e legjenda*, 1974, parathënia e *Këngë kreshnike I*, Prishtinë, 1979, etj.).

Autori termin letërsia popullore gojore e quan të pandashëm dhe të qëlluar meqë këtë e përdor, anise për këtë nuk jep shpejgim, por është e qartë se ai, në një anë do ta ruajë traditën, dmth., ta përdorë termin e njohur tradicionalisht letërsi popullore dhe nga ana tjetër atij ia shton termin *gojore*, i cili sot është në përdorim të gjerë në shkencën e letrësisë.

Problemi i terminologjisë përkatëse shtrohet kështu si pikënisje e çfarëdo diskutimi tjetër në këtë drejtim dhe (megjithëse termi letërsi gojore është i miratuar dhe i përdorur, ndërsa tek A. Çetta, letërsi popullore gojore) argumentet për termin letërsi popullore gojore gjejnë mbështetje, në mënyrën e krijimit dhe të lindjes së veprës letrare gojore. Sepse, siç thotë R. Jakobsoni, lidhur me përralën, të cilën e quan: „pasuri tipike kolektive popullore”, të socializuar duke shtuar se „përralla dhe gjuha janë ato që iu shtrohen ligjeve uniformuese më shumë se çdo lloj tjetër i krijimit individual”. Prandaj karakteri masiv dhe përcjellja e një krijimi të tillë individual gojore e bën të qëndrueshëm pohimin se letërsia gojore, edhe duke qenë krijim individual, me mënyrën e përcjelljes të marrësi ndryshon nga ajo e shkruara, pikërisht me veprimin uniformues të vlerave të para.

Kënde del analogjia në vetë procesin e zgjedhjes së materialeve gjatë mbledhjes së tyre nga folkloristi me zgjedhjen të cilën e bën gjuhëtari. Edhe njëri edhe tjetri nga situata e caktuar, nga gjuha e rëndomtë e komunikimit ndajnë vetëm atë që është e qëndrueshme, ose nga të treguarit e zakonshëm. Kjo analogji këtu ndihmon për një drejtim fillestar metodologjik kur është fjala për trajtimin e çështjeve a problemeve të përgjithshme të letërsisë gojore po edhe për çështjen e ndarjes dhe të emërtimit më të plotë dhe të saktë të llojeve të kësaj letërsie. Klasifikimi dhe ndarja e llojeve, pra, ka lidhje të

drejtperdrejtë me të kuptuarit e zanafillës së krijimit gojor.

Ndonjëherë format e shkurtëra të letërsisë gojore merren sikur janë „pjesë e letërsisë së njimendte”. Formulimet e tilla gjuhësore mund të hasën kur flasin dy persona mes vete, e veçanërisht, kur ata bëjnë fjalë për të tretin.

Këto formulime të thjeshta studiohen si elemente të letërsisë „së madhe” „të letërsisë së njimendte”, duke ndjekur rrugën e shqyrtimit të llojeve të njohura, duke i lënë m’anas llojet minore dhe përgjithsisht krijimet dhe formulimet e tilla të letërsisë gojore.

Në këtë mes klasifikimi i letërsisë gojore është kërkesë e dorës së parë, e cila mund të bëhet nga pikëmbështetja teorike të ndryshme, d.m.th. me kritere të ndryshme. Gjatë trajtimit teorik të llojeve të tilla preferohet të mos fillohet nga të magjepsurit, të mrekulluarit të marrësit në përjetimin e fenomenit letrar si të tillë dhe që imponohet kur vëmë kontakt me krijime gojore të tilla, që janë të vlerës njëmend epokale. Pra shtrohet nevoja që këto krijime minore (për nga forma), të merren si krijime më vete dhe si lloje të veçanta, jo si elemente përbërëse të „një veprë të madhe”.

Në vështrim të parë të thjeshtë formulimet e tilla nuk dallojnë fort nga të folurit e përditshëm, po ato, janë të tilla, në radhë të parë për shkak të qëndrueshmërisë së formës artistike, në kuptimin e formës si karakter shoqëror të veprës artistike, për veçantitë dhe afektivitetin e tyre si konstituentë letrarë. Pra, veprimi i zgjedhjes së vlerave të qëndrueshme nga ana e mbledhësit të folklorit tregon për nevojën e përcaktimit të termave që mund t’i quajmë ndryshe çelës të shqyrtimit.

Kështu, interesimi i mbledhësit të folklorit është i lidhur ngushtë me atë të interpretuesit të po këtij materiali.

A. Çetta në studimin e tij *Për një ndarje më të plotë të prozës popullore dhe emërtimin e ca llojeve të saj bën gërshetimin dhe zbatimin e rezultateve të orientimeve nga këto dy fusha interesimesh Kështu, studimi në ballë të Kërkimeve folklorike, bën fjalë për prozën popullore,*

shtron çështjen e periodizimit dhe të emërimit më të plotë të llojeve të krijimeve gojore, duke hedhur dritë mbi këto çështje. Në pjesën ku shqyrtohet „Ndarja dhe emërtimet e gjertanishme të llojeve të prozës popullore, A. Çetta jep historikun e klasifikimit të llojeve të prozës, që, siç theksohet këtu „u bë gjatë vitesh...“, ashtu siç mblihdeshin shkallë shkallë shkallë edhe vetë materialet folklorike në prozë nga shkencëtarët dhe dashamirët e letërsisë sonë gojore”.

Ndërsa nën pikën 11 të po kësaj teme *Për plotësimin e ndarjes dhe të emërtimeve të llojeve të prozës popullore* ku është për t'u veçuar mendimi prijës i autorit „... duhet të mos ngurrojmë e të mos frikësohemi se mos po bëjmë ndonjë hap të gabueshëm nëse largohemi nga pak nga format e vjetra, të njohura mirë. Sepse, disa materiale të reja të mbledhura në kohë të fundit na imponojnë të krijojnë lloje të reja të prozës popullore e të gjëjmë emërtime të reja që përpara nuk i kishim”.

Prozën popullore autori e ndan në dy grumbuj të mëdhenjë *Tregimet popullore dhe llojet minore të prozës popullore*.

Meqë llojin e parë tregimet popullore i përcakton sikunder edhe deri më tash si proza” që kanë etapat e syzheut, në llojet minore të prozës popullore. A. Çetta, me formim të mirë filologjik, shqyrton dhe rishqyrton termat letrarë dhe çështjen e periodizimit të letërsisë gojore.

Në pjesën e dytë të librit të shqyrtim autori bën fjalë për fenomenet e poezisë gojore shqipe dhe për disa tipare të saj. Kështu në mënyrë të veçantë ai shqyrton çështjen e baladës dhe të transformimit të strukturës së saj, këngët e dasmës dhe nënllojet e tyre, pastaj flet për gjenezën dhe për këngën e Kurt Mehmetit dhe Sadik Ramës të familjes së Gjonbalaj nga Vuthaj etj. Edhe kjo pjesë dëshmon për njohjen e thellë të problemeve dhe për aftësitë e autorit që ato t'i hetojë dhe shkoqisë nga disa aspekte.

Në fund po themi se libri *Kërkime folklorike* i A. Çettës është me interes të shumëfishtë për folkloristikën tonë.

ISMAIL BELAJ

ALBANSKE JUNAČKE PESME, zgjodhi dhe përktheu Dragutin Miqoviqi, „Jedinstvo”, Prishtinë, 1981.

Ndërmarrja Gazetare-Botuese „Jedinstvo” e Prishtinës, në edicionin e Bibliotekës së Letërsisë Popullore, në verën që shkoi lëshoi në shitje veprën *Albanske junačke pesme* (Këngë shqiptare të trimërisë), zgjedhur dhe përkthyer nga Dragutin Miqoviqi. Në të vërtetë, këtu kemi të bëjmë me 18 këngë kreshnike shqiptare e jo me aso të trimërisë, siç është titulluar vepra, ndonëse në serbokroatishte ndoshta mund të shkojë edhe kështu në një kuptim më të gjerë, por pasi M. në 16 faqet e parathënies flet vetëm për këngët kreshnike shqiptare, mendojmë se edhe titulli i mirëfilltë *Albanske krajišničke pesme* e më mirë edhe *krešničke*, do ta arsyetonte më tepër përmbajtjen e veprës.

Kur Radosav Medenica në *Rad XIV kongresa folklorista Jugoslavije u Prizrenu*, Beograd, 1974, f. 233. na

informoi se Dragutin Miqoviqi i kishte përkthyer në prozë nja njëzet këngë kreshnike shqiptare në serbokroatishte, u gëzuam. Por, u gëzuam edhe më shumë, kur këto këngë na ranë në dorë të publikuara. Na u duk kënaqësi e posaçme, që diçka nga thesari i madh i krijimtarisë sonë popullore me larushi të madhe motivo-re, me vlera të larta letrare — artistike e gjuhësore — stilistike, i është ofruar lexuesit që e di serbokroatishten.

Pasi i lexuam këto dhe i krahasuam me origjinalet, vërejtëm se përkthimi është bërë shkel e shko, pa përgjegjësi e me shumë të meta, të cilat gjymtojnë dukshëm një përceptim më të plotë e të saktë të vlerave reale të kësaj krijimtarie nga ana e lexuesit në gjuhën serbokroate anipse përkthyesi disa herë këto vlera i përmend në parathënie.